

## Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime”, 2023

**Tiranë, më 12 Nëntor 2024:** Në vitin 2023, numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi (brenda apo jashtë Shqipërisë), të kryera nga individët banues në Shqipëri të moshës mbi 15 vjeç ishte 4.399.859. Ky tregues është 17,4 % më i lartë se në vitin 2022. Udhëtimet për qëllime personale përbëjnë 97,5 % të udhëtimeve gjithsej, ndërsa udhëtimet për qëllime biznesi 2,5 % të tyre. Përqëndrimet më të larta të udhëtimeve të kryera janë regjistruar në muajt:

- Gusht 14,9 %;
- Dhjetor 11,9 %;
- Korrik 11,5 % ;
- Qershor 10,4 %.

Nëse do të analizojmë disa karakteristika kryesore të udhëtimeve, përqëndrimin më të lartë në Shqipëri e shënojnë udhëtimet për qëllime personale (3,4 milion) dhe jashtë vendit ato për qëllime biznesi (0,06 milion).


“Pushime dhe kohë e lirë” përbën qëllimin më kryesor të udhëtimeve të kryera si në Shqipëri (49,4%) ashtu dhe jashtë saj (47,2%).

Udhëtimet e kryera jashtë Shqipërisë për qëllime “Vizita te të afërm dhe miq”, kanë shënuar rritjen më të lartë me rreth 5,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2022.

Në vitin 2023, përqindjet më të larta të udhëtimeve, brenda (22,9%) dhe jashtë Shqipërisë (30,4%), janë kryer nga grup-mosha 25-34 vjeç.

Numri mesatar i netëve të qëndrimit për udhëtime të kryera është 4,14 netë. Vlerat më të larta të shumës së netëve të qëndrimit (në milion) janë regjistruar në muajt Gusht, Korrik, Janar dhe Qershor, Fig.1.

**Fig.1 Numri i udhëtimeve dhe shuma e netëvetë qëndrimit sipas muajit të nisjes, 2023, në milion**



**Udhëtimet sipas qëllimit**


Karakteristikë e këtij viti është rritja më e lartë vjetore e shënuar për udhëtimet për qëllime personale (30,6%) dhe biznesi jashtë Shqipërisë (53,6%).

**Tab.1 Shpërndarja e numrit të udhëtimeve sipas qëllimit, 2022–2023**

Qëllimi i udhëtimit	2022		2023	
	Nr. udhëtime (në milion)	%	Nr. udhëtime (në milion)	%
Personale në Shqipëri	2,96	79,1	3,40	77,2
Personale jashtë Shqipërisë	0,69	18,3	0,90	20,4
Biznesi në Shqipëri	0,06	1,6	0,05	1,2
Biznesi jashtë Shqipërisë	0,04	1,0	0,06	1,3
<b>Gjithsej</b>	<b>3,75</b>	<b>100,0</b>	<b>4,40</b>	<b>100,0</b>

Në 2023, udhëtimet e kryera brenda dhe jashtë Shqipërisë për “Pushime dhe kohë e lirë” zënë peshën më të madhe, ndjekur nga udhëtimet e kryera jashtë Shqipërisë për qëllime “Vizita të afërme dhe miq”.

**Fig.2 Shpërndarja sipas qëllimit të udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2022-2023, në %**



Nëse do të analizojmë më në detaj kohëzgjatjen e udhëtimeve sipas qëllimit në Shqipëri dhe jashtë saj, vërejmë se udhëtimet për "Pushime dhe kohë të lirë" kanë kohëzgjatje të shkurtër, brenda dhe jashtë vendit, përkatësisht me (58,3 %) dhe (60,7 %). Udhëtimet për "Vizita të afërme dhe miq" kanë kohëzgjatje të shkurtër brenda vendit (90,7 %) dhe kohëzgjatje të gjatë jashtë vendit (86,3 %). Udhëtimet kryera për qëllime biznesi kanë kohëzgjatje të shkurtër, në Shqipëri (79,3 %) dhe të gjatë jashtë saj (64,0 %).


**Tab.2 Shpërndarja e udhëtimeve sipas qëllimit, kohëzgjatjes brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2023, në %**

Kohëzgjatja e udhëtimit	Në Shqipëri				Jashtë Shqipërisë			
	Pushime dhe kohë e lirë	Vizita të afërme dhe miq	Biznes	Të tjera	Pushime dhe kohë e lirë	Vizita të afërme dhe miq	Biznes	Të tjera
Udhëtime të shkurtra	58,3	90,7	79,3	87,0	60,7	13,7	36,0	25,8
Udhëtime të gjata	41,7	9,3	20,7	13,0	39,3	86,3	64,0	74,2

**Udhëtimet sipas destinacioneve**

Në vitin 2023, destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri janë qarqet: Tiranë (18,2 %), Vlorë (14,5 %), Korçë (11,7 %) dhe Durrës (9,7 %). Në udhëtimet kryera jashtë Shqipërie përqindjet më larta janë regjistruar në: Greqi (7,7 %), Itali (6,3 %) dhe shtete të tjera (Spanjë, Angli, etj.) (2,4 %).


Fig.3 Përqindja e udhëtimeve sipas destinacioneve më të frekuentuar në Shqipëri dhe jashtë saj 2023, në %



**Shpërndarja e udhëtimeve, sipas llojit të akomodimit**

Lloji më i shpeshtë i akomodimit në vitin 2023, është “të qëndruarit tek të afërmit ose miqtë”, ndjekur nga kategoria “hotel” dhe “ambiente akomodimi me qira” apo “shtëpi ose apartamente të dyta për pushime”. Në vitin 2023, vërehet një rritje për përdorimin e formave alternative të akomodimit (si kamping, llixha dhe shtëpi pushimi), krahasuar me vitin 2022.


Fig.4 Shpërndarja e udhëtimeve, sipas llojit të akomodimit, 2022 - 2023, në %



### Udhëtimet sipas llojit të transportit

Rreth 3,88 milionë udhëtime janë kryer nëpërmjet transportit rrugor të cilët përbëjnë 88,1 % të të gjithë udhëtimeve të kryera në vitin 2023. Rritja më e lartë është regjistruar në transportin rrugor me 1,8 pikë përqindje.

Fig.5 Shpërndarja udhëtimeve sipas mënyrës së transportit, 2022-2023, në %



# Metodologjia

Anketa e Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime" është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësisive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri mbi 15 vjeç. Anketa mbledh të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetjeje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu edhe ato brenda ditës brenda/ jashtë vendit të ndarë në katër tremujorë përkatësisht: Tremujori i parë (Janar-Mars), tremujori i dytë (Prill-Qershor), tremujori i tretë (Korrik-Shtator), tremujori i katërt (Tetor-Dhjetor). Anketa e Turizmit në Familje, "Pushime dhe Udhëtime" u krye për herë të parë në vitin 2017 përgjatë gjithë vitit me një kampion përfaqësues për të gjithë Shqipërinë.

Në vitin 2023, anketa e Turizmit në Familje, "Pushime dhe Udhëtime" u krye me një kampion prej 10.240 NjEF, ku për çdo tremujor anketa përfshin një kampion prej 2.560 familjesh ose 320 PSU.

Në përfundim të vrojtimit u intervistuan rreth 7.198 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 70,3 %.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 8 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme.

## **Mbledhja e të dhënave:**

Kryhet një interviste direkte nga anketuesit me pyetësor letër ku përfshihen pyetje për familjen dhe të dhënat bazë në lidhje me të si dhe realizohet intervistë individuale për çdo person prezent në NjEF mbi 15 vjeç.

## **Struktura e pyetësorit:**

- Informacion i përgjithshëm;
- Karakteristikat demografike të anëtarëve të NjEF-së;
- Pyetësi Individual (karakteristika socio-demografike, numri dhe karakteristikat e udhëtimeve me fjetje dhe udhëtimet një ditore).

**Përkufizime:**

**Turizmi** është veprimtaria e vizitorëve duke ndërmarrë një udhëtim për një destinacion kryesor jashtë vendbanimit të zakonshëm ku jeton, për më pak se një vit, për çfarëdo qëllimi kryesor, duke përfshirë biznesin, kohën e lirë apo qëllime tjera personale. Personi vizitor nuk duhet të jetë i punësuar nga një subjekti rezident në vendin e vizituar.

**Vizitor** është klasifikuar një turist (ose vizitori për një ose më shumë netë), në qoftë se udhëtimi i tij / saj përfshin një qëndrim me fjetje.

**Vizitor një ditë** është një udhëtar ose turist i cili nuk qëndron gjatë natës në vendin ku ka udhëtuar.

**Udhëtar** do të konsiderohet individ i cili lëviz në vendeve të ndryshme gjeografike për çdo qëllim dhe kohëzgjatje.

**Udhëtimi** i referohet veprimtarisë së udhëtarëve.

**Turizëm i brendshëm** përfshin aktivitetet e një vizitori rezident brenda vendit.

**Turizëm i jashtëm** përfshin aktivitetet e një vizitori rezident jashtë vendit të referencës.

**Udhëtim për qëllime personale:** Udhëtime për qëllime personale janë ato udhëtime jashtë vendbanimit të zakonshëm të individit, të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj.

**Udhëtim për qëllime biznesi ose pune:** Udhëtime për qëllime biznesi janë ato udhëtime jashtë vendbanimit të zakonshëm të individit, të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj (kongrese dhe konferenca, panairë dhe ekspozita, bisedime për biznes dhe misione (shitje ose blerje), udhëtime profesionale (të ndërmarrë nga përfaqësuesit e kulturës apo religjionit, etj), trajnimin, shoqërimin e personave të tjerë, etj).

**Destinacioni kryesor:** në rastin e një udhëtimi jashtë vendit, individit deklaron se ku ka qëndruar. Në qoftë se udhëtari nuk është në gjendje për të vendosur, udhëtari do vendosë si destinacionin kryesor vendin ku ai ka shpenzuar kohën më të madhe të netëve të qëndrimit; në qoftë se ka shumë vende me numër të njëjtë të qëndrimeve me fjetje atëherë do vendoset destinacioni më i largët apo vendi ku udhëtari ka shpenzuar më shumë para.

**Netët e qëndrimit:** janë netët e qëndrimit në një hotel ose ambient i ngjashëm, në një banesë private me qira ose jo me qira (akomodimi ofrohet nga miqtë apo të afërmit), ose në natyrë (kamping). Gjithashtu në netët e qëndrimit janë të përfshira netët e kaluara në mjetet e udhëtimit (në tren, autobus).

**Kohëzgjatja e udhëtimit:** Numri i netëve të qëndrimit.

**Qëllimi kryesor i udhëtimit:** Qëllimi kryesor i udhëtimit është ai që i përshtatet më mirë sipas të intervistuarit. Është shumë e rëndësishme që të veçohen udhëtimet për qëllime personale nga ato për biznes ose punë.